

Agimi kishte shumë probleme me policinë serbe përpara fillimit të luftës dhe u detyrua të emigronte në Zvicër. Në datën 4.06.1998, ai u kthye në Kosovë dhe menjëherë u inkuadrua në UÇK. Përderisa me traktor të mbushur me ushqime për UÇK-në po kalonte nëpër fshatin **Voksh/Vokša**, më 7.07.1998, dikush ka shtënë ndaj tij. Ka mbetur i vdekur në vend. Një ditë më vonë, bashkëlufëtaret e kanë varrosur në një fushë pranë shtëpisë së Qaush Nitajt. Pas përfundimit të luftës, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Agimit në varrezat në vendlindjen e tij në Sllup/Slup.

**Burimet:** deklarata H.M, FDH-31236; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; deklarata M.M, FDH-12260.

### Kolë (Ndrecë) Miredita

(9.02.1976, shqiptar nga Ranoci/Renovac, komuna e Klinës/Klina, pjesëtar i UÇK-së)

Kola iu bashkëngjiti UÇK-së në pranverë të vitit 1998. Në fund të qershorit të të njëjtit vit, ai me një grup burrash nga Ranoci/Renovac dhe fshatra të tjera përreth shkuan në Shqipëri për të siguruar armatime të reja. Gjatë kthimit, pasi e kaluan kufirin më 9.07.1998 te **Juniku/Junik**, kanë rënë në pusi të forcave serbe. Pjesëtarët e grupit u shkapërderdhën befasisht në të gjitha anët. Nga ajo ditë, Kolës i humbet çdo gjurmë. Për fatin e tij nuk dihej asgjë për një kohë të gjatë. Dy vjet më vonë, trupin e tij e ka gjetur Nikë Frroku, pjesëtar i UÇK-së. E varrosën në Rranoc/Renovac më 29.09.2000.

**Burimet:** deklarata S.R, FDH-7139; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...* 8, 133-137.

### Petar (Sava) Rajković

(18.07.1976, serb nga Dubovci, komuna e Kovinit, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Petar e kishte të mbaruar Shkollën e Punëve të Brendshme në Kamenicën e Sremit. Punonte në Shërbimin e Punëve të Brendshme në Kovin. Për të parën herë e çuan në Kosovë në verë të vitit 1997. Ka

shkuar sërish atje në fund të qershorit të vitit 1998. Në datën 10.07.1998, atë e plagosën rëndë në një postbllok policor në **Prilep**. Menjëherë e çuan në AMU në Beograd, por së shpejti ka dhënë shpirt. U varros në varrezat e fshatit të lindjes në Dubovc, më 12.07.1998.

**Burimet:** deklarata S.R, FDH-29798; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 59; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 934; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110.

### Ivan (Miodrag) Eraković

(1.06.1967, serb nga Prokupla, një fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Ivani e kishte mbaruar shkollën e lartë të bujqësisë, e më pas edhe trajnimin për oficer police në vitin 1994. Menjëherë pas trajnimit, ka filluar nga puna në brigadën e SPB-së në Beograd. Ivani ka shkuar për të parën herë me njësitin e tij në Kosovë në pranverë të vitit 1998. Për të tretën herë radhazi, ai ka shkuar në Kosovë më 1.07.1998. E kishin caktuar me detyrë në Deçan/Deçane. Dy ditë më vonë, më 12.07.1998, familjes së tij i ishte bërë e ditur zyrtarisht se Ivani ka rënë në betejë me forcat e UÇK-së në fshatin **Carrabreg/Crnobreg**. Më 14.07.1998, Ivanin e kanë varrosur në varrezat Selishte, në afërsi të qytetit të tij të lindjes së Prokuples.

**Burimet:** deklarata M.E, FDH-24717; SMIP, *Teroristički...*, III, 935; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 27; Z. Stijović, *Kosmet...*, 110; M. Sekulić, *Beograd...*, 38.

### Dejan (Vladimir) Mihajlović

(17.09.1971, serb nga Uzhica, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Dejani e kishte të mbaruar shkollën e mesme mekanike dhe trajnimin për polic-i. U punësua në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) të Serbisë më 21.09.1991. Përpara shkuarjes në Kosovë, punonte pranë stacionit kufitar policor në Limanin e Beogradit. U vra gjatë përlëshjeve me pjesëtarët e UÇK-së më 11.07.1998, që kanë ndodhur në postbllokun policor në fshatin **Strelc i Epërm/Gornji Streoc**.